



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datën 21.03.2014 Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin policor për kontroll kufitare në Aeroportin "Aleksandri i Madh". Vizita u realizua me bashkëpunëtor të jashtëm nga Shoqata maqedonase e juristëve të rinj, shoqatë e regjistruar për dhënien e ndihmës juridike falas për azilkërkuesit në Qendrën pranuese për azikërkues.

Qëllimi i vizitës është përcaktuar konform Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Tajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese, është identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose formave tjera të trajtimit brutal, johuman, nënçmues ose ndëshkues.

Gjatë vizitës së Stacionit policor për kontroll kufitare të Aeroportit „ Aleksandri i Madh” u realizua bisedë me kryeshefin e SP, ndërsa më pas u realizua inspektim në ambientet e stacionit policor, si dhe inspektim në evidencat për personat e privuar nga liria. Njëherazi MPN monitoroi edhe kthimin e shtetasve maqedonas për shkak të qëndrimit të palejueshëm në shtete të jashtme. Kthimi ishte organizuar nga ana e Agjencisë Evropiane FRONTEKS, ndërsa MPN përmes bisedave të drejtpërdrejta fitoi informatë se në cilën mënyrë dhe në çfarë kushte janë deportuar këta persona, si dhe për mënyrën e trajtimit të tyre në Republikën e Maqedonisë në hyrje të Aeroportit "Aleksandri i Madh".

Stacioni policor për kontroll kufitare (SPKK) "Aleksandri i Madh" është vendosur në dy objekte, përkatësisht disa ambiente të cilat i shfrytëzojnë zyrtarët policorë gjenden në vet ndërtesën e Aeroportit „ Aleksandri i Madh”, ndërsa vet stacioni policor është vendosur në barakë te Aeroportit të vjetër-Petrovec.

Konform informatave të kryeshefit të stacionit policor privimi i përkohshëm bëhet në ambientin e përgjegjësit të turnit të aeroportit, ku personat këshillohen për të drejtat dhe arsyet se përse janë ndaluar. Në ambientin e njëjtë ku ndalen përkohësisht personat bëhet kontroll dhe përpilohet shënimi zyrtar. Pas verifikimit se, a janë plotësuar kushtet për ndalje, personat transportohen prej aeroportit deri në stacionin policor.

Kryeshefi e njoftoi MPN se në këtë stacion policor ndalimi zgjat më së shumti tre orë, edhe pse i njëjti nuk është përcaktuar me Aktvendim të Ministrisë për Punë të Brendshme në grupin e stacioneve policore ku mund të bëhet ndalimi. Në stacionin policor personat qëndrojnë në sallën për mbledhje. Objekti i stacionit policor është i ri, mirëmbahet në mënyrë të rregullt dhe në mënyrë përkatëse janë theksuar të drejtat e personave të privuar nga liria.

Aeroporti i Shkupit ka në dispozicion edhe ambientet e veçanta për ndalim të azikërkuesve. Gjatë inspektimit të ambienteve, ishte vërejtur se në të njëjtat ka broshura të Seksionit për azil të MPB-së në disa gjuhë nëmes të cilave edhe arabishte, somalishte, farsi etj.

Policia për kontroll kufitare, në vet aeroportin, disponon edhe me ambiente për gjumë (2 dhoma me nga 2 krevatë dhe tualet) dhe ambientin-karantin të lidhur me ambulancën. Deri më tani në ambientet për gjumë nuk janë vendosur azilkërkuesit, ndërkaq, janë vendosur persona të cilëve nuk u është lejuar hyrja në shtet dhe më së shpeshti kanë pasur fluturim për kthim mbas për dy deri më tre ditë, me ç'rast kanë pasur mundësi që lirisht të lëvizin në zonën e transitit të aeroportit dhe kanë fituar ushqim nga avio-kompania me të cilën është dashur të realizojnë fluturimin.

Gjatë monitorimit të kthimit të shtetasve maqedonas për shkak të qëndrimit të paleje në shtetet e jashtme, u konstatua se personat zyrtarë veprojnë konform kornizës nacionale ligjore dhe standardet ndërkombëtare. Të gjithë personat ishin të nacionalitetit rom të cilit kishin kërkuar azil në shtete anëtare të Unionit Evropian.

Nga ana e policisë, u realizua bisedë informative për menyrën e daljes nga shteti si dhe për arsyet e kthimit të tyre. Biseda realizoheshte në ambient të veçantë nën video-mbikëqyrje. Të drejtat e personave ishin theksuar dukshëm në ambientin ku realizohen biseda. Në mënyrë plotësuese, kryeshefi informonte se të njëjtëve do t'u sekuestrohen pasaportat.

Në këtë SPKK personave të ndalur përkohësisht u bëhet me dije se kanë të drejtë për mbrojtës, përkatësisht mund të thërrasin sipas zgjedhjes personale ose të zgjedhin nga lista e avokatëve me të cilët disponon stacioni. Njëkohësisht stacioni policor siguron edhe kujdesin mjekësor gjatë 24 orëve nga ambulanca e aeroportit.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitës së SP për kontroll kufitare Aeroport realizoi inspektim në evidencën e plotë e cila ka të bëjë me personat e privuar nga liria, saktësisht u realizua inspektim në Librin për persona të privuar nga liria dhe ndalje, në Librin për ngjarje ditore, Librin për persona të arrestuar, evidencën për sende të sekuestruara përkohësisht, gjithashtu u kontrolluan 6 dosarë individual për persona të privuar nga liria sipas zgjedhjes së rastësishme.

Gjatë inspektimit u konstatua se të njëjtit udhëhiqen me azhuret dhe në mënyrë të drejtë. Nga inspektimi në Procesverbalin për ndalim MPN konstatoi se i njëjti plotësohet në mënyrë të drejtë, personi në mënyrë të drejtë këshillohet për të drejtat e veta në procedurë policore. Në të gjithë procesverbalet ishte plotësuar pjesa për njoftim me të drejtat, pjesa për lëndimet e personit ( ka ose nuk ka lëndime të dukshme), shenja të sëmundjes dhe nevojën për mjek gjatë pranimit të personit.

Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë për vizitën e realizuar në të cilën u konstatuan gjendje pozitive dhe negative dhe u dhanë rekomandime përkatëse pranë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pranë kryeshefit të SPKK "Akesandri i Madh".